

Kreditimi Rural i Kosovës, me seli në Prishtinë, është institucion Mikrofinanciar. Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të departamentit të Auditimit të Brendshëm, KRK kërkon të bëjë Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë së Departamentit të Auditimit të Brendshëm dhe publikon këtë shpallje:

Kërkesë për propozim për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë së Auditimit të Brendshëm

KRK është një institucion mikrofinanciar (IMF), i fokusuar në dhënien e kredive të vogla për individët, fermerët dhe ndërmarrjet mikro/të vogla dhe te mesme në zonat rurale dhe urbane.

Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë së departamentit të Auditimit të Brendshëm ka për qëllim që të vlerësojë se proceset e auditimit nga departamenti i auditimit të brendshëm janë në përputhje me Politikat, Procedurat dhe dokumentet tjera të KRK-së dhe poashtu të njëjtat janë në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloret e BQK-së dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Objektivi final i vlerësimit është ngritja e cilësisë së auditimit nga departamenti i auditimit të brendshëm.

Vlerësimi duhet të mbulojë fushat e mëposhtme (ToR);

- Të vlerësojë përputhshmërinë me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës dhe sipas rastit mund të përmbajë rekomandime për ngritje të cilësisë.
- Të vlerësojë Politikat, Procedurat, bashkë me Statutin dhe Proceset e auditimit të brendshëm në përputhje me standardet.
- Të vlerësojë procesin e vlerësimit të rrezikut, procesin e përcaktimit të fushëveprimit të auditimit të brendshëm dhe procesin e planifikimit vjetor të auditimit të brendshëm.
- Të kryej një rishikim të raporteve finale dhe materialeve të tjera të përgatitura nga departamenti i auditimit të brendshëm.
- Të kryej një intervistë me menaxherin e departamentit të auditimit të brendshëm për të mbledhur informacion dhe dokumentuar përputhjen e tij me standardet.
- Të kryej punë duke përfshirë teste të kufizuara të dokumenteve burimore (vlerësimet e rrezikut, dokumentet e punës së auditimit).
- Të kryej intervista të shkurtra me anëtarët e përzgjedhur të komitetit të auditimit, menaxhmenti ekzekutiv, për të marrë një tregues të pavarur në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e auditimit të brendshëm.
- Të vlerësojë efektivitetin e auditimit të brendshëm në ofrimin e shërbimeve të sigurimit dhe këshillimit.
- Të rekomandojë praktikën me të mira profesionale të auditimit të brendshëm.

Zbatimi dhe afati kohor;

Kompania e përzgjedhur, duhet të dorëzojë në KRK draft raportin me shkrim që mbulon ToR, jo më vonë se data **20 Qershor 2022**. Vlerësimi dhe raporti përfundimtar duhet të përfundojë deri më **15 Korrik 2022**.

KRK për kompanitë e interesuara ose ekspertë individualë, do të ofrojë informacionin e nevojshëm në lidhje me strukturën e departamentit të auditimit të brendshëm.

Kërkesat për kualifikim;

Ofertat e paraqitura, përveç tjerash, duhet të përmbajnë:

- Licencën nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar,
- Certifikatën e regjistrimit në ARBK,
- Përvojat në auditimin e bankave dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë,
- Rekapitullimin lidhur me numrin e stafit dhe përvojat e tyre, (Ekspertët e kompanisë ose individ duhet të kenë kualifikimin (ABÇ ose CIA), të paktën tri vjetë përvojë të kohëve të fundit në praktiken e auditimit të brendshëm dhe ekspertizën përkatëse në sektorin e auditimit të brendshëm).
- Specifikimin e mbështetjes së disponueshmërisë nga partnerët e jashtëm,
- Raporti duhet të ofrohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze,
- Ofertën financiare.

Përzgjedhja e ofertës së përshtatshme do të zgjidhet në bazë të vlerësimit të ofertës në terma të ToR, ekspertizës së kompanisë, afatit kohor dhe kostos financiare.

Pranimi i ofertave bëhet nga dt. 08.06.2022 deri më dt. 16.06.2022.

Nëse keni nevojë për ndonjë informacion lidhur me përgatitjen e ofertës, ju lutemi të drejtoheni me kërkesë në formë të shkruar.

Kompanitë e interesuara mund të dërgojnë ofertat e tyre përmes adresës elektronike: krk_imf@krk-ks.com ose direkt në Zyrën Qendrore të KRK-së, Rruga Behije Dashi nr. 20, Prishtinë.